

Udhëzime për provimin për nëpunës administrativ

Në bazë të nenit 40 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë, kandidati për nëpunës administrativë jep provim për nëpunës administrativ i cili organizohet dhe zbatohet nga Agjencia e administratës.

1. Provimi për nëpunësit administrativë përbëhet nga dy pjesë: secila me kohëzgjatje nga 60 minuta dhe në mënyrë të njëpasnjëshme:
 - pjesa profesionale (60 minuta); dhe
 - pjesë për testimin e njohurive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht); (60 minuta)

Në pjesën profesionale duke iu përgjigjur pyetjeve në formë testimi kompjuterik, kontrollohen njohuritë e kandidatit në fushat e mëposhtme:

- rendi kushtetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- sistemi i vetëqeverisjes lokale,
- sistemin e së drejtës administrative, procedurën administrative dhe kontestim administrativ,
- pozita dhe çështje të tjera të përgjithshme për të punësuarit në sektorit publik,
- të drejtat për marrëdhënie pune të nëpunësve administrativë dhe
- kodeksi për nëpunësit administrativë

Pjesa profesionale e provimit për nëpunës administrativ sjell maksimum **25 pikë**, dhe do të konsiderohet i kaluar nëse kandidati fiton të paktën **15 pikë**.

Kandidati që ka dhënë pjesën profesionale të provimit administrativë, vazhdon me dhënien e provimit në pjesën për kontrollë të njohurive të një prej të tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), ndërsa kandidati i cili nuk e ka dhënë pjesën profesionale të provimit për nëpunës administrativ do të konsiderohet se nuk e ka dhënë provimin e nëpunësit administrativ.

Pjesa për kontroll të njohurive të një prej tre gjuhëve më të përdorura Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) përbëhet nga pyetje që kanë tre shkallë të kompleksitetit për kategori të ndryshme të vendeve të punëve të nëpunësve administrative dhe mbajnë të njëjtin numër të pikave.

Pjesa për kontroll të njohurive të një nga tre gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) ka maksimum **15 pikë** dhe do të konsiderohet i kaluar nëse kandidati fiton të **paktën 8 pikë**.

2. Provimi për nëpunës administrativ mbahet në sallë të posaçme të pajisur me pajisje informative, rrjetë interneti, pajisje për inçizimin e provimit dhe displej për shfaqjen e rezultateve.

3. Para fillimit të provimit/testimit, secili prej kandidatëve të pranishëm në sallë, identifikohet dhe më pas ata njoftohen për rregullat e provimit/testimit. Kandidati para se të fillon me provimin e ndal telefonin celular, pajisje kompjuterike dhe paisje tjera teknologjike.

4. Dhënia e provimit, përkatësisht testi inçizohet dhe transmetohet drejtpërdrejt në ueb faqen e Agjencisë, dhe nëse për shkaqe teknike ndërpritet inçizimi, ai do të postohet në faqen e internetit të Agjencisë.

5. Kandidati i nënshtrohet provimit për nëpunës administrativ duke e futur kodin indentifikues për aktivizimin e testimit dhe dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të parashtruara në kompjuterin në të cilin është i ulur, me ç'rast kandidati zgjedh përgjigjen e saktë nga përgjigjet e ofruara, në të njëjtën kohë kandidati mund të kthehet në pyetjet e mëparshme dhe të ndryshojë përgjigjet e dhëna, derisa nuk e zgjidhni opsionin "përfundo provimin dhe llogarit pikët", pas së cilës provimi përfundon dhe llogariten pikët e fituara për pjesën përkatëse të provimit.

6. Kandidatit gjatë dhënies së pjesës profesionale të provimit, gjegjësisht në pjesën për kontroll të njohurive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), nuk ju lejohet përdorimi i literaturës, ligjeve dhe nuk i lejohet të kontaktojë me kandidatë të tjerë ose persona nga Agjencia përveç me informaticienin i punësuar në Agjenci, nëse ka problem teknik me kompjuterin gjatë provimit. Nëse kandidati vepron në kundërshtim me kushtet e mësipërme gjatë provimit, ai do të largohet nga provimi dhe do ti jepet vendim për ndalim të dhënies së provimit për nëpunës administrativ për periudhë tre vjeçare. Po ashtu, për të njëjtën inicohet edhe procedurë kundërvajtëse, për të cilën është paraparë gjobë shumë prej 100 deri në 200 euro në kundërvlerë në denarë në pajtim me nenin 101 paragrafi (5) të Ligjit për nëpunës administrativ.

7. Rezultati, gjegjësisht numri i përgjithshëm i pikëve nga provimi për nëpunës administrative, kandidatit i jepet në kompjuterin në të cilin ka dhënë provimin dhe së bashku me emrin dhe mbiemrin e kandidatit publikohet edhe në ekran për shpalljen e rezultateve menjëherë pas përfundimit të provimit nga secili kandidat. Njoftimi në ekran zgjat të paktën dhjetë minuta pas përfundimit të provimit nga të gjithë kandidatët të cilët e kanë dhënë provimin. Menjëherë pas provimit, rezultati i kandidatit regjistrohet në Agjenci dhe mund të përdoret për procedura të tjera përzgjedhjeje brenda një viti nga dita e pare e dhënies së provimit.

8. Pas përfundimit të provimit/testimit, pra pas skadimit të kohës së provimit/testimit, kandidati largohet nga dhoma.

9. Menjëherë pas përfundimit të provimit/testimit nga të gjithë kandidatët që në të njëjtën kohë e kanë dhanë provimin, kamera e zmadhon ekranin dhe të paktën pesë minuta live në uebfaqja e Agjencisë, transmeton në ekran rezultatet e të gjithë kandidatëve që kanë dhënë provimin. Rezultatet e provimit të të gjithë kandidatëve të renditur sipas pikëve të fituara të provimit publikohet në faqen e Agjencisë dhe dërgohet menjëherë në adresat e postes elektronike të të gjithë kandidatëve që kanë hyrë në provim.

Nëse keni ndonjë pyetje që nuk ka përgjigje në këtë udhëzues, mund të kontaktoni në e-mailin e mëposhtëm: kontakt@aa.mk

VËREJTJE E RËNDËSISHME: Kandidatët, nuk do të testohen në pjesën për kontrollimin e njohurive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht), përkatësisht nuk do të vlerësohen me pikë deri më 26.07.2018. Gjegjësisht, kandidatët që në periudhën e

lartpërmendur deri më 26.07.2018 do të lidhin marrëdhënie pune janë të obliguar që këtë pjesë të provimit për nëpunës administrativ ta japin në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për nëpunës administrativ (Gazeta zyrtare e RM-së numër 11/2018).

Nëse kandidatët që lidhin marrëdhënie pune deri më 26.07.2018, kanë marrë një certifikatë të njohur ndërkombëtarisht ose vërtetim të njohur ndërkombëtarisht deri në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për nëpunës administrativ (Gazeta zyrtare e RM-së numër 11/2018) nuk do të testohen në pjesën për kontrollimin e njohurive të një prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) por certifikatën, gjegjësisht vërtetimin që do ta dorëzojnë te punëdhënësi ku ka lidhur marrëdhënie pune.